



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:045000

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05922793

C.nr. 153/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen civilo – juridike të paditësve; M.B, SB, S.B, A.B, B.B, P.B dhe L.B, te cilin perfaqson sipas autorizimit S.B, nga fsj.GJ, K.S, kundër të paditurve H.B dhe R.B, të cilët i përfaqëson e autorizuara N. H, avokate nga S, me objekt të kontestit, identifikim të pronës, vendosje të stinorëve dhe dorëzim të pronës, gjykata pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 18.06.2024, më datë 10.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve, me të cilën kanë kërkuar që, citojmë: *MIRATOHET kërkesëpadia e paditësve të përfaqësuar me autorizim nga paditësi S, B nga fshati Gj. K e S, dhe at lirimin dhe kthimin e pjesës 1977 m² të PP-1124, pronë e paditësve. DETYROHEN të paditurit H.B dhe R.B nga Gj i S, që këtu paditësve t’ua kthejnë dhe lirojnë në shfrytëzim pjesën 1977m² të P-1124 dhe atë menjëherë nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi e nën pasojat përmbarimore. OBLIGOHEN të paditurit që këtu paditësve t’ua kompensojnë shpenzimet e procedurës.*
- II. OBLIGOHEN paditësit, që t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës palës së paditur Hajrush Berisha në shumën prej 1714.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha procedurale e çështjes

Paditësi me datë 25.07.2014, ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate me objekt kontesti identifikim dhe dorëzim të pronës si dhe vendosjes e stinoreve. Gjykata me aktvendimin C.nr.359/19, e ka ndërprerë procedurën kontestimore për shkak të vdekjes së paditësit dhe ka udhëzuar që e njëjta mund të vazhdohet pas marrjes në dorë të procedurës nga trashëgimtarët e paditësit. Trashëgimtari i paditësit S. B, sipas parashtrësës së datës 11 mars 2016, ka bërë kërkesë për vazhdimin e procedurës, ku të njëjtës parashtrësë ia ka bashkangjitur edhe aktvdekjen e paditësit. Gjykata sipas aktvendimit C.nr.75/2016, e ka obliguar trashëgimtarin S. B, që të bëjë

precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë në aspektin subjektiv. Trashëgimtari i paditësit me parashtrësën e datës 2 shtator 2019, ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv, ku si paditës i ka shtuar M. B, S.Sh, S.B, A. B, B. B, P. B, si dhe L. B.

Kjo gjykatë me datë 03.04.2024, ka caktuar seancën përgatitore, ku i autorizuari i palëve paditëse, ka deklaruar se babai i tyre është ndarë para shumë viteve me mixhallarët Ahmetin dhe Islamin, po ashtu ka shtuar se ara e tyre i ka pasur 91 ari, e cila është evidentuar me nr. P -1124, ZK – Gjinoc, pastaj ka deklaruar se babai i tij i ka blerë 3 ngastra tjera ngjitur me këtë ngastër ku njëra mban numrin 1118-1, me sipërfaqe prej 9 ari, tjetra 1118-2, me sipërfaqe prej 16.85 m2, tjetra nr. 1118-3 me sipërfaqe prej 301 m2 si dhe parcelën 1124 me sipërfaqe prej 91.61 m2, ku ka theksuar se të gjitha këto janë të evidentuar si në parashtrësën e datës 13.09.1999 dhe (17.09.1999). Tutje ka shtuar se këto ngastra babai i tyre i ka përkthyer pas luftës.

Në seancën kryesore të datës 18.06.2024, ka qëndruar në tërësi si në deklaratimet nga seancat e kaluara, duke kërkuar që të ekzekutohet dokumenti i UNMIK-ut dhe KFOR-it, lëshuar me datë 13.09.1999 dhe 17.09.1999, ndërsa sa i përket ngastrave 1117-3 dhe 1124-3, ka shtuar se nuk kemi kërkesë për faktin se të njëjtat evidentohen në emër të vëllait – paditës në këtë çështje, tutje ka shtuar se parashtrësës së datës 10.06.2024, ia kemi bashkangjitur parashtrësën e KFOR-it së bashku me skicën e siguruar nga K e S.

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar gjykatës me shkrim me datë 20.06.2024, ka shtuar se me rastin e dhënies me qira të pronës tonë KFOR-it, nga kontingjenti Gjerman mbas sigurimit të pronës së pronarit përmes UNMIK-ut, e që shihet nga marrja në bisedime e datës 17.09.1999, ku procesi është hartuar me datë 13.09.1999, shihet qartë se parcela me nr. 1124, me sipërfaqe prej 9160 m², aq sa ka pasur sipërfaqe i është dhënë në shfrytëzim KFOR-it. Tutje ka shtuar se të paditurit pas kthimit të pronës, ngastrës 1124, të njëjtit e kanë përpjesëtuar, pra parceluar pasurinë pa dijen e paditësve dhe në këtë mënyrë kanë krijuar njësi të reja. Nga kjo ndarje ka theksuar se paditësit janë dëmtuar, gjegjësisht nga ndarja e ngastrës 1124, e cila në fillim kishte sipërfaqe prej 9160 m², ku më pas i janë dorëzuar vetëm 7183 m², pra i mungon pjesa prej 1977 m². Bazuar nga këto fakte i ka propozuar gjykatës që të e aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve si dhe të detyrohen të paditurit që paditësve t'ia lirojnë dhe t'ia kthejnë në shfrytëzim pronën pjesën prej 1977 m² të parcelës dhe atë menjëherë nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit R. B, në përgjigje në padi si dhe gjatë seancës përgatitore të datës 03.04.2024, ka deklaruar se mbesim pranë përgjigjes në padi, të dorëzuar gjykatës me shkrim, përmes të cilës kemi kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se me asnjë provë materiale nuk e kanë mbështetur kërkesëpadinë.

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit R. B, av. S. S, përmes parashtrësës së datës 30.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se me që i padituri është paraqitur në seancën e terrenit dhe me meqenëse me të njëjtin nuk ka arritur e as ka insistuar që të bëjë marrëveshje për përfaqësim të mëtutjeshëm, detyra e saj si përfaqësuese e përkohshme pushon.

I padituri R. B, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 18.06.2024, ka deklaruar se këto ndarje janë nga ndarja faktike paraprakisht e bashkësisë familjare e të parëve tanë, diku rreth viteve 1974, ndërsa ndarjet juridike i kemi ndarë sipas marrëveshjes me kontrata të lidhur tek noteri në vitin 2019. Tutje ka shtuar se kjo ndarje ka ardhur si pasojë e asaj se si i kemi shfrytëzuar tokat, si i kemi punuar, ku për këtë jemi marr vesh të gjithë pasardhësit duke respektuar ndarjet faktike të vitit 1974. Në vazhdim ka shtuar se edhe sot nuk e kam të qartë se pse duhet të merremi me këtë proces gjyqësor, kur këtë çështje e kemi zgjidhur tek noteri sipas kontratave. Po ashtu ka shtuar se për arsye se gjendet jashtë shtetit, e autorizon av. N. H, që ta përfaqëson në këtë çështje, e cila i ka të gjitha autorizimet për përfaqësim në të gjitha shkallët.

E autorizuar e paditësit R. B, në fjalën përfundimtare të dorëzuar gjykatës me shkrim me datë 21.06.2024, ka theksuar se, nga vetë provat materiale të bashkangjitura padisë, precizimit të padisë dhe dëgjimi të palëve ndërgjyqëse si dhe deklarimit të paditësit, marrjes së provës me ekspertizë, nuk është kuptuar se cila është baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve në këtë çështje kontestimore. Tutje ka shtuar se me datë 20.10.2018, në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurë jashtëgjyqësore është bërë ndarja e pasurisë dhe e ngastrave kadastrale që kanë qenë objekt i kërkesëpadisë së paditësve dhe pasi që të njëjtit kanë nënshkruar ndarjen e parcelave sipas posedimit qysh prej vitit 1975, kur edhe kanë ndarë bashkësinë faktike familjare, janë regjistruar ndarjet në kadastër dhe në vitin 2019 është bërë bartja e paluajtshmerive përmes kontratën mbi dhuratën LRP.nr.1990/2019, Ref.nr.319/19, të dt.29.03.2019, në emër të njërit nga paditësit P. B dhe ngastrat tjera në emër të R. B. Andaj ka shtuar se nga të lartë cekurat, gjykatës i propozojmë që në kuptim të nenit 8 të LPK-së, pas vlerësimit të të gjitha provave veç e veç, kërkesëpadinë e palëve paditëse të e refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E autorizuar e të paditurit H. B, në seancën përgatitore, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në deklarimet nga seancat e mëparshme, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, ka deklaruar se pas marrjes së provës me ekspertizë nga ana e ekspertit gjeodet është vërtetuar fakti se pronat objekt i kërkesëpadisë së paditësit nuk janë nuk janë të regjistruara në emër të të paditurit H. B, tutje ka shtuar se po ashtu pas vërtetimit të gjendjes faktike në terren, i njëjti nuk është as posedues faktik i këtyre ngastrave objekt kontesti, andaj ka theksuar se ne si palë e paditur nuk duhet me qenë palë për faktin se nga mungon legjitimiteti.

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar gjykatës me shkrim më 21.06.2024, ka theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësve, ka shtuar se ngastrat kadastrale objekt i kërkesëpadisë 1117-2 dhe 1124, evidentohen në emër të R. B, si pronar juridik. Po ashtu ka theksuar se me datë 20.10.2018, në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurë jashtëgjyqësore është bërë ndarja e pasurisë dhe e ngastrave kadastrale që kanë qenë objekt i kërkesëpadisë së paditësve dhe pasi që të njëjtit kanë nënshkruar ndarjen e parcelave sipas posedimit qysh prej vitit 1975 kur edhe kanë ndarë bashkësinë faktike familjare, ka theksuar këto ndarje janë regjistruar në kadastër dhe në vitin 2019 është bërë bartja e pasurisë sipas kontratës mbi dhuratën LRP.nr.1990/2019, Ref.nr.319/2019, të dt. 29.03.2019, në emër të njërit nga paditësit P. B, dhe ngastrat tjerat në

emër të Refik Berishës. Në fund i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve të e refuzoj si të pabazuar për shkak të legjitimitetit pasiv të palës në procedurë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

- Procedura e provave

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejt dhe më të saktë të gjendjes faktike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, në procedurën e provave ka bërë administrimin e këtyre provave: është bërë shikimi në parashtrësën e KFOR-it, UNMIK-ut, e dt. 17.09.1999 dhe e datës 13.09.1999, certifikatën e pronës, e lëshuar me datë 23.07.2014 për ngastrat 1118-1, 1118-2, e evidentuar në emër të M. A. B, certifikatën e lëshuar me datë 23.07.2014, në emër të H. A. B, për ngastrat 1124-0 dhe 1117-0, aktvdekjen e lëshuar për M. B, me datë 26.11.2015, certifikatën e pronës e lëshuar me datë 30.08.2016, në emër të H. A. B, përgjigja e zyrës kadastrale e dt. 21.11.2018, për historiatin e ngastrës 1117-0 dhe 1124-0, certifikatën për ngastrën 1117-3, e lëshuar me datë 14.11.2022, e evidentuar në emër të P. B – paditësit, certifikatën e lëshuar me datë 16.11.2022, në emër të H. A.B, për ngastrën 1117-1 dhe 1124-1, certifikatën për ngastrën 1124-3, e lëshuar me datë 14.11.2022, e evidentuar në emër të P. B– paditësit , së bashku me kontratën për dhurimin e hartuar tek noteri LRP.nr.1990/2019, me nr. 319/19, e datës 23.09.2019, së bashku me skicat e bashkangjitura, ekspertizën gjeodezike të ekspertit L. A, të datës 10.05.2024, së bashku me skicat e lokacionit, ortofotot, skicat e pjesëve në shfrytëzim dhe certifikata e pronës për ngastrat 1117-2, 1117-3, 1124-2 dhe 1124-3, të dt. 10.05.2024. parashtrësën e dt. 10.06.2024, të paditësit, dorëzuar në gjykatë së bashku me skicën e cila në aspektin formal nuk është e protokolluar, e njëjta nuk ka datë, e as vit.

Gjykata, nga provat e administruara si më lart, e pas çmuarjes me ndërgjegje të secilës provë veç e veç e të ndërlidhura së bashku, konform nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar, për çka vendosi që ta refuzoj të njëjtën, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Pretendimet e palëve

Pretendimet e paditësve, në fillim të procesit gjyqësor sipas padisë kanë qenë rregullimi i mexhëve për ngastrat kadastrale 1118/1, 1118-2, 1118-3, 1117 dhe 1124.

Me parashtrësën e datës 02.09.2016 i njëjti e ka ndryshuar kërkesëpadinë në aspektin objektiv, ku ka kërkuar dorëzimin e një pjese të ngastrës 1124-2 dhe 1117-2.

Me parashtrësën e datës 22.11.2022, paditësi ka precizuar sërish kërkesëpadinë duke kërkuar vërtetimin e së drejtës së bashkëpronësisë mbi bazën e trashëgimisë për ngastrat 1117/2, 1124-2, 1114-0 dhe 1117-3.

Ndërkaq në seancën e datës 17.01.2023, sërish e ka ndryshuar padinë në aspektin objektiv, tani duke kërkuar tani vërtetimin e pronësisë për pjesën e ngastrës 1124-2 dhe 1117-2. paditësi edhe në seancën e datës 03.04.2024, e ka bërë ndryshimin e padisë në aspektin objektiv, ku ka kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit janë pronarë sipas bazës së trashëgimisë nga babai i tyre, për një pjesë të ngastrës 1124-2, pjesërisht për ngastrën 1117-2.

Ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim të datës 20.06.2024, i njëjti ka kërkuar nga të paditurit H dhe R. B, që t'ia kthejnë dhe lirojnë në shfrytëzim sipërfaqen prej 19 ari e 77 m² të parcelës 1124.

Ndërsa të paditurit vazhdimisht i kanë kundërshtuar pretendimet e paditësve me arsyetimin se ngastrat të njëjtit i kanë në shfrytëzim që nga ndarja e bashkësisë familjare nga viti 1974, ndërsa ndarjet juridike janë bërë sipas marrëveshjes së palëve gjate vitit 2019.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se këtu ngastrat objekt kontesti kanë qenë të bashkësisë familjare, ku në këtë periudhë këto ngastra janë evidentuar si ngastra me numër 1117-0 dhe ngastra 1124-0, e të cilat janë përkufizuar njëra me tjetrën, ndërsa me rastin e ndarjes së bashkërisë familjare gjate vitit 1974/75, është bërë ndarja faktike e tyre, ku secili prej tyre i ka punuar deri në kohën e luftës në Kosovë. Pas përfundimit të luftës këto ngastra janë marr për shfrytëzim me qira nga ana e KFOR-it, ndërsa pas lirimit të ngastrave nga ana e tyre, këtu palët ndërgjyqëse kanë filluar sërish shfrytëzimin e të njëjtave. .

- Gjendja faktike e vërtetuar

Nga shikimi në certifikatën e lëshuar me datë 23.07.2014, në emër të H. A. B, për ngastrat 1124-0 dhe 1117-0, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela 1117-0 si dhe parcela 1124-0, si posedues individual me 1/1 është i padituri H. B. Po ashtu këtë fakt gjykata ka vërtetuar edhe përmes certifikatës së pronës , të lëshuar me datë 30.08.2016, ku si pronar ka vazhduar të jetë i padituri H. B.

Nga shikimi në ekspertizën gjeodezike të ekspertit L. A, të datës 10.05.2024, së bashku me skicat e lokacionit, ortofotot, skicat e pjesëve në shfrytëzim dhe certifikata e pronës për ngastrat 1117-2, 1117-3, 1124-2 dhe 1124-3, të dt. 10.05.2024, rezulton se parcela kontestuese 1117-2 sipas certifikatës së pronës e dt. 10.05.2024 evidentohet në emër të të paditurit R.B. Për të dhënë sqarime në lidhje me ekspertizën e tij gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, ka ftuar ekspertin gjeodet L.A, për të dhënë sqarime në lidhje me ekspertizën e tij. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, eksperti ka theksuar se parcela 1124-0, ka pësuar ndarje, ku është parceluar në tre parcela të reja, pra parcelat 1124-1, 1124-2 dhe 1124-3, ku ngastra 1124, pas ndryshimeve të bëra në mes të palëve, kontratave tek noteri, si dhe pas ndryshimeve në zyrën kadastrale është konstatuar se përputhet gjendja faktike me atë juridike të këtyre ngastrave. Këtij deklarami të ekspertit gjykata ia fal besimin për faktin se si nga certifikatat e pronësisë e po ashtu edhe nga kontrata tek noteri, pronarë i ngastrave kontestuese mbi të cilat paditësit pretendojnë se iu takon një pjesë për ta plotësuar kërkesën e tyre, ashtu siç pretendojnë, ku si burim e cila derivon kjo kërkesë është parashtresa e KFOR-it, është i padituri R.B, i cili

këto ngastra i shfrytëzon dhe i punon qysh nga ndarja faktike e bashkësisë familjare në mes të prindit të tij dhe mixhallarëve, babait të paditësve.

Kësaj prove gjykata ia fal besimin për faktin se gjykata së bashku me ekspertin gjeodet dhe palët ndërgjyqëse ka dalë në vend të ngjarjes për të njohur nga afër më gjendjen faktike në terren në drejtim të asaj se kush i punon ato toka, me çfarë kulture janë të mbjella, ku gjatë seancës së terrenit ka vërtetuar faktin se ngastrat kontestuese, punohen faktikisht ashtu siç evidentohen edhe në kadastrë, pra ngastrën 1117 -2, si dhe ngastrën 1124-2 e punon i padituri R.B. Ndërkaq ngastrat 1117-3, 1124-3, janë në shfrytëzim nga paditësit, ku si paditësit ashtu edhe të paditurit i kanë në shfrytëzim ngastrat e tyre edhe faktikisht ashtu siç përkufizohen edhe sipas kadastrit këto ngastra. Pra, nga seanca e terrenit, gjykata ka vërtetuar faktin se palët ndërgjyqëse janë duke i shfrytëzuar secili pjesën e tij ashtu siç këto ngastra janë të ndara edhe sipas kadastrit.

Nga shikimi në përgjigjen e zyrës kadastrale e dt. 21.11.2018, për historiatin e ngastrës 1117-0 dhe 1124-0, të njëjtin kanë përshkruar rrjedhën e historiatit të pronave objekt kontesti, ku kanë theksuar se këto parcela kadastrale deri në vitin 2018, nuk kanë pasur ndarje zyrtare në drejtorin tonë, kështu që ne nuk posedojmë formën e ndarjes si dhe pjesën e pronës (gjegjësisht) sipërfaqet se si janë ndarë këto parcela kadastrale në periudhën e mëhershme. Kanë shtuar se ndarja e këtyre parcelave kadastrale është bërë në bazë të kërkesës së palëve të gjodeti privat i licencuar A. R, me datën 17.10.2018, ku me rastin e daljes në terren kanë qenë prezent H. B, R.B dhe M.B, të cilët i kanë dhënë sugjerimet se si duhet të ndahen këto parcela. Kësaj prove gjykata ia fal besimin për faktin se nuk përmes saj vërtetohet fakti se cila ka qenë gjendja juridike e ngastrave 1117 dhe 1124 deri në kohën kur janë parceluar me ndarje në vitin 2018, pra ndërgjyqësit sipas vlerësimit të gjykatës ngastrat objekt kontesti deri në atë kohë i kanë shfrytëzuar vetëm faktikisht sipas marrëveshjes së paraardhësve të tyre, ndërsa ndarjen juridike të njëjtit e kanë bërë me gjeodet të licencuar me datë 17.10.2018.

Nga shikimi në certifikatën e pronës për parcelën 01124-2, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri R.B, identifikohet si posedues individual mbi bazën e kontratës mbi shitblerjen LRP.nr. 116 – 2019 Ref. nr. 012 – 2019, e datës 04.01.2019. Pra sipas kësaj prove gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri ka fituar pronësinë nga pronari juridik edhe pse faktikisht kjo ngastër është shfrytëzuar vazhdimisht nga paraardhësit e palëve ndërgjyqëse, ndërsa kontrata e shitblerjes këtu të paditurit i ka shërbyer vetëm si titull juridik për bartjen e pronësisë nga personi i tretë (pronari juridik) tek i njëjti.

Nga shikimi në certifikatën për ngastrën 1124-3, e lëshuar me datë 14.11.2022, e evidentuar në emër të P.B, paditësit, së bashku me kontratën për dhurimin e hartuar tek noteri LRP.nr.1990/2019, me nr. 319/19, e datës 23.09.2019, së bashku me skicat e bashkangjitura, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas kontratës mbi dhurimin e paluajtshmerisë, ku në cilësi të dhuratëdhënësit H. A. B, ndërsa në cilësi të dhuratëmarrësit P. B, është bërë ndarja e parcelës 1124-3, ku mbi bazën e dhurimit këtu i padituri H. B, ndërsa sipas kontratës mbi dhuratën, dhuratëdhënësi ia ka dhuruar parcelën në fjalë këtu paditësit, ndërsa sipas kontratës dhuratëmarrësit, për faktin se nga ndarja e bashkësisë familjare nga paraardhësit e tyre këtë parcelë e ka shfrytëzuar dhe punuar paditësit P. B, ku mbi bazën e këtyre deklarimeve ka

vendosur që të njëjtit t'ia kaloj parcelën në fjalë. Gjykata ia fal besimin kësaj prove për faktin se njëjta është hartuar te organi kompetent.

Nga shikimi në aktvdekjen e lëshuar për M. B, me datë 26.11.2015, gjykata ka vërtetuar çështjen e legjitimitetit të palëve paditëse në këtë çështje kontestimore.

Nga shikimi në certifikatën e pronës, e lëshuar me datë 23.07.2014 për ngastrat 1118-1, 1118-2, gjykata ka vërtetuar faktin se parcelat e lartpërmendura, evidentohen në emër të M. A. B, babai i paditësve. Kjo provë nuk është relevante për gjykatën për faktin se këto ngastra nuk janë objekt kontesti tani pas precizimit të kërkesëpadisë nga ana e paditësve.

Nga shikimi në certifikatën për ngastrën 1117-3, e lëshuar me datë 14.11.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo parcelë evidentohet me 1/1 në emër të P. B. Po ashtu gjykata konstaton se meqenëse parcela në fjalë tani më nuk është objekt kontesti nuk është lëshuar më tutje në komentimin e kësaj prove, pasi që edhe vetë paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, ka deklaruar se sa i përket parcelave 1117-3 dhe 1124-23, nuk kemi kërkesë, për faktin se evidentohen në emër të paditësit, vëllait P. B.

Po ashtu edhe nga shikimi certifikatën e lëshuar me datë 16.11.2022, në emër të H. A. B, për ngastrën 1117-1 dhe 1124-1, gjykata ka vërtetuar faktin se këto ngastra evidentohen në emër të të paditurit H. B.

Nga shikimi në certifikatën e pronës së datës 10.05.2024 për parcelën 1117-3, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo parcelë është në emër të paditësit P. B, ku kjo parcelë paditësit i ka kaluar mbi bazën e kontratës mbi dhurimin e paluajtshmerisë, LRP.nr. 1990 – 2019, Ref . nr. 319/2019, e datës 29.03.2019.

Nga shikimi në certifikatën e datës 10.05.2024, për parcelën 01124-3, gjykata ka vërtetuar faktin se në posedim individual me 1/1 për këtë parcelë identifikohet paditësi P. B, parcelë kjo e cila i ka kaluar sipas kontratës mbi dhurimin e paluajtshmerisë LRP.nr. 1990 – 2019, ref. nr. 319/2019, të datës 29.03.2019.

Nga shikimi në parashtresën e datës 10.06.2024, të paditësit, dorëzuar në gjykatë së bashku me skicën e cila në aspektin formal nuk është e protokolluar, e njëjta nuk ka datë, e as vit. Gjykata kësaj prove nuk ia fal besimin për fakti se e njëjta nuk i plotëson kushtet në aspektin formal, e njëjta nuk është hartuar nga organi kompetent, po ashtu e njëjta nuk ka as datë dhe as vit. Madje këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga konstatimi i ekspertit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, i cili ka konstatuar se kjo skicë nuk është zyrtare, nuk as vulë dhe as numër të protokollit.

Nga shikimi në certifikatën e pronës, e lëshuar me datë 23.07.2014 për ngastrat 1118-1, 1118-2, gjykata ka vërtetuar faktin se parcelat e lartpërmendura, evidentohen në emër të M. A. B, babai i paditësve. Kjo provë nuk është relevante për gjykatën për faktin se këto ngastra nuk janë objekt kontesti tani pas precizimit të kërkesëpadisë nga ana e paditësve.

Nga shikimi në parashtrësën e KFOR-it, UNMIK-ut, e dt. 17.09.1999 dhe ajo e datës 13.09.1999, e cila evidentohet me titullin “marrja në bisedime”, nga e njëjta gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paraardhësit të palëve paditëse i janë marrë në shfrytëzim për interes të vendosjes së tyre për çështje sigurie. Në këtë parashtrësë shihet se nga M. B. janë marrë parcela 1124, 1118-1, 1118-2 dhe 1118-3, në fshatin Gj, K e S. Kësaj prove gjykata nuk ia falë besimin për faktin se kjo parashtrësë nuk është e kompletuar në aspektin formal, të njëjtës i mungon skica, plani, pozita e vendit, protokollu, foto dokumenti, video dokumenti, certifikata e pronësisë, pra në këtë parashtrësë janë të evidentuara vetëm ngastrat me dorë, për çka për gjykatën nuk është provë e cila do të kontribuonte në vërtetimin e faktit në drejtim të asaj se sa ka qenë sipërfaqja e saktë e këtyre parcelave, kush ka qenë pronar i këtyre parcelave, pra kjo parashtrësë për gjykatën ka të meta në aspektin formal dhe e njëjta përveç ngritjes së dyshimeve – supozimeve, të cilat krijojnë mëdyshje tek paditësit se cila ka qenë sipërfaqja e vërtetë e ngastrave kontestuese, nuk provon ndonjë fakt tjetër e cila do të kontribuonte paditësit për vërtetimin e të drejtës së tij subjektive.

- Baza ligjore dhe vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Ligji Nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS, i cili ligj ka hyrë në fuqi me datë 20.08.2009), më saktësisht kapitulli III, që ka të bëjë me fitimin dhe humbjen e të drejtës së pronësisë parashih mënyrat dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të kaluar pronësia mbi një send të paluajtshëm nga një pronar tek tjetri. Në këtë drejtim neni 36 par. 1 i këtij ligji shprehimisht thotë *“Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”*, ndërsa par. 2 i po këtij neni thotë: *“Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente”*.

Në këtë drejtim edhe Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike (LMTHJP), që ka qenë në fuqi para Ligjit Nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, më saktësisht neni 20 përcaktonte se pronësia fitohet *“sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”*, ndërsa neni 33 i po këtij ligji përcaktonte se *“Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”*. Neni 21 i LMTHJ liston mënyrat e fitimit të të drejtave pronësore të cilat mund të arrihen përmes ligjit: *krijimi i një sendi të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me parashkrim fitues*.

Pra, si çështje kryesore në këtë lëndë është nëse paditësit i takon pjesa të cilën e pretendon mbi bazën e parashtrësës së KFOR-it, ku parcela 1124 i është marrë në shfrytëzim, si dhe e njëjta pas ndarjes është parceluar në tre pjesë ku nga pjesa që i është kthyer paditësit, i njëjti pretendon se i mungon një pjesë me një sipërfaqe prej 19 ari e 77 m².

Pas analizimit dhe vlerësimit të fakteve të cilat i kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar në ligj dhe fakte. Gjykatës i rezultoi se pretendimi i paditësve për të fituar të drejtën që t'iu kthehet sipërfaqja prej 19 ari e 77 m² është i pabazuar.

Sipas nenit 319 të LPK-së, citojmë *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.”*

Faktin se paditësve i është marrë dhe nuk i është kthyer sipërfaqja kontestuese, paditësit e bazojnë mbi bazën e parashtesës së datës 17.09.1999, ku kësaj parashtrese ashtu siç theksuar edhe më lartë gjykata nuk ia fal besimin për faktin se e njëjta nuk i përmbush kushtet formale, nuk është hartuar tek organi kompetent, e po ashtu nuk ka bashkangjitur as skicë e as ortofotot të hartuara nga ndonjë ekspert i licencuar apo zyra kadastrale.

Po ashtu paditësit nuk e kanë bindur gjykatën me asnjë provë të vetme se para së ngastrat objekt kontesti të merren në shfrytëzim nga ana e KFOR-it, të njëjtit kanë pasur në shfrytëzim sipërfaqen e kërkuar prej 91 ari e 77m². Ndërkaq të kundërtën e pretendimeve të tyre gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara në këtë proces gjyqësor nga të cilat shihet se këtu vet palët ndërgjyqëse i kanë bërë parcelimet e ngastrave sipas marrëveshjeve të tyre, kontratave, kjo vërtetohet sipas histotiatit të zyrës kadastralë në Suharekë të datës 21.11.2018, shihet se ngastrat 1117-0 dhe ngastra 1124-0, janë parceluar përmes gjeodetit të licencuar A. R me datë 17.10.2018, ku në rastin e tyre kanë prezantuar për paditësi M.B, si dhe të paditurit, H.B dhe R.B, ku edhe ndarjet janë bërë sipas marrëveshjes së tyre. Andaj nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se nuk qëndron pretendimi i paditësve se i është marrë sipërfaqja kontestuese të cilat fillimisht kanë qenë pjesë e parcelës 1124.

Meqenëse rastin konkret konform nenit 322.2 të LPK-së i cili përcakton se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, barra e provës bie mbi palët paditëse, kjo edhe bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* dhe nga kjo rrjedh se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim, që në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj.

Ndërkaq nga vlerësimi i konstatimit të ekspertit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024, i cili ka konstatuar se po të merrej për bazë sipërfaqja që paditësit pretendojnë pra sipërfaqja prej 91 ari e 60 m², atëherë do të duhej të merret komplet ngastra 1124 - 2 e të paditurit R.B, në mënyrë që të krijohet sipërfaqja që paditësit pretendojnë. Po ashtu eksperti edhe në pyetjen e gjykatës se a është zyrtare e besueshme dhe e plotë parashtresa e referuar si skicë e ngastrave objekt kontesti, e datës 10.06.2024, ka deklaruar se kjo skicë nuk është zyrtare, për faktin se nuk ka as vulë, nuk ka numër të protokollit.

Nga deklarimi i të paditurit H. B në fjalën përfundimtare, i njëjti ka konstatuar se qysh prej vitit 1974, i kemi shfrytëzuar ngastrat ashtu siç janë ndarë nga paraardhësit e tyre dhe se pjesa

kadastrale kontestuese i takon djalit të vëllait R, ndërsa te kundërtën e këtyre theksimeve nuk kanë mundur që ta vërtetojnë fare paditësit me asnjë prove te vetme.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike kontestimore. Përfundimisht gjykata vlerëson se paditësit me provat e ofruara, nuk kanë arritur të provojnë se të njëjtëve iu takon pjesa prej 1977 m², të cilët pretendojnë se ju është uzurpuar kundërligjshëm. Nga provat e lartcekura gjykata nuk ka mundur të vendos ndryshe, përveç se sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që palët paditëse me asnjë provë konkrete nuk kanë arritur ta bindin gjykatën për realizimin e të drejtës së tyre.

Lidhur me vendosjen mbi shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-s, ku i obligon palët paditëse që t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore te paditurit H. B, siç vijojnë: për kundërshtim të masës së përkohshme, shumën prej 208.00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro, për shtatë seanca të mbajtura në gjykatë nga 135.00 euro, gjithsej 945.00 euro, për 4 seanca të pa mbajtura pa fajin e të paditurit 270.00 euro, për dy seanca të terrenit, ajo e datës 04.12.2018 si dhe seanca e terrenit e datës 29.04.2024 nga 135.00 euro, gjithsej 270.00 euro, të gjitha këto shpenzime në shumën e përgjithshme prej 1714.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokateve. Ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve te kërkuara mbi shumën e vendosur refuzohet si e pabazuar.

Andaj nga të lartcekurat e mbi bazën e nenit 143 të Ligjit të procedurës kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:045000, 10.07.2024**

Gjyqtari:

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Ky aktgjykim mund të kontestohet me ankesë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, për në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet të kësaj gjykate. Afati i paraqitjes së ankesës fillon me marrjen e vendimit.